



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008 dhe nenit 40 shkronja h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes propozon:

Që duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 2 paragrafi 4 dhe nenit 10 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019 , nenit 2 të Memorandumit të Mirëkuptimit të lidhur në mes të Komunës së Fushë Kosovës, Komunës së Lipjanit, Komunës së Obiliqit, Komunës së Podujevës, Komunës së Prishtinës dhe Qendrës për Mbrojtjen e grave dhe fëmijëve në Prishtinë Nr.1-660/03-53582 të datës 04.10.2022; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____ 2026, të miratojë këtë:

PROPOZIM

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR QENDRËN PËR MBROJTJEN E GRAVE DHE FËMIJËVE - STREHIMOREN NË MBROJTJE TË VIKTIMAVE TË DHUNËS FAMILJARE DHE ATYRE TË DHUNËS GJINORE

I. MIRATOHET, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 2,848.00 € (dy mijë e tetëqind e katërdhjetë e tetë euro), për ta mbështetur financiarisht mbulimin e pjesërishëm të shpenzimeve të Strehimores, objekti i së cilës gjendet në Komunën e Prishtinës dhe ju shërben gjashtë Komunave nënshkruese të këtij Memorandumi në mënyrë që strehimorja të kryej funksionin e saj në mbrojtje të viktimave të dhunës familjare dhe atyre të dhunës gjinore.

II. Ndarja e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi bëhet konform dispozitave të Memorandumit të Mirëkuptimit të lidhur në mes të Komunës së Fushë Kosovës, Komunës së Lipjanit, Komunës së Obiliqit, Komunës së Podujevës, Komunës së Prishtinës” dhe Qendrës për Mbrojtjen e grave dhe fëmijëve në Prishtinë si dhe kërkesës së QMGF dërguar Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale të datës 16.05.2025 në të cilën përcaktohet obligimi i komunave të cekura për mbulimin e pjesërishëm të shpenzimeve të strehimores për periudhë tre (3) vjeqare 2023, 2024 dhe 2025 dhe konkretisht kontributi

financiar i Komunës së Lipjanit i kalkuluar për vitin 2025 për strehimoren do të jetë 2,848.00 € (dy mijë e tetëqind e katërdhjetë e tetë euro).

III. Shuma e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi do të ndahen nga të hyrat vetanake të Komunës, kategoria ekonomike - subvencione dhe transfere të planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës për vitin 2026, programi – 16003, fondi burimor: 21/613/16003/200/00000/0111.

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

V. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në fagen zyrtare të Komunës

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim - Vendimi është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 2 paragrafi 4 dhe neni 10 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, si dhe nenit 2 të Memorandumit të Mirëkuptimit të lidhur në mes të Komunës së Fushë Kosovës, Komunës së Lipjanit, Komunës së Obiliqit, Komunës së Podujevës, Komunës së Prishtinës” dhe Qendrës për Mbrojtjen e grave dhe fëmijëve në Prishtinë si dhe kërkesës së QMGF dërguar Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale me datës 16.05.2026, në të cilën përcaktohet obligimi i komunave të cekura për mbulimin e pjesërishëm të shpenzimeve të strehimores për periudhë tre (3) vjeqare 2023,2024 dhe 2025 dhe konkretisht kontributi financiar i Komunës së Lipjanit i kalkuluar për vitin 2024, për strehimoren do të jetë 2,848.00 € (dy mijë e tetëqind e katërdhjetë e tetë euro)

Ndarja e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Propozim - Vendimi bëhet konform dispozitave të nenit 2 të Memorandumit të Mirëkuptimit të lidhur në mes të Komunës së Fushë Kosovës, Komunës së Lipjanit, Komunës së Obiliqit, Komunës së Podujevës, Komunës së Prishtinës dhe Qendrës për Mbrojtjen e grave dhe fëmijëve në Prishtinë për mbulimin e pjesërishëm të shpenzimeve të Strehimores, objekti i së cilës gjendet në Komunën e Prishtinës dhe ju shërben gjashtë Komunave nënshkruese të këtij Memorandumi në mënyrë që strehimorja të kryej funksionin e saj në mbrojtje të viktimave të dhunës familjare dhe atyre të dhunës gjinore.

Nga të cekurat më lartë kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 400/01-4458
Lipjan, më 28.01.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





QENDRA PËR MBROJTJEN E GRAVE DHE FËMIJËVE- QMGF
CENTRE FOR PROTECTION OF WOMEN AND CHILDREN – CPWC

Adress: str. Lagjia Ulpiana, rr. Imzot Nike Prela, 50, Prishtinë

Tel&Fax: 00 383 (0) 38 54 54 76

E-mail: prishtinaqmgf@gmail.com

Mobil: 00 38344/425/111

Për: Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale –Komuna e Lipjanit
Nga: OJQ “Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve” -Prishtinë

Lënda :

K Ë R K E S Ë

I/e nderuar,

Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve është strehimore që ofron shërbime për viktimat e dhunës në familje nga regjioni i Prishtinës dhe më gjerë. Komuna e Lipjanit ndërvite e ndihmon strehimoren në forma të ndryshme. Më 04.10.2022. u nënshkrua vazhdimësia e Memorandum Mirëkuptimit për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për strehimoren për një periudhë tre vjeçare (2023-2025). Bazuar në nenet e këtij Memorandumi, janë bërë kalkulimet konform obligimeve për secilën komunë, ndërsa Neni dy në pikën gjashtë specifikohet:

„Nëse disa komuna vendosin ta rrisin kontributin e tyre me vetëdëshirë, kjo nuk do të ketë pasoja për obligimet e komunave tjera të përcaktuara me MM“.

Shuma që duhet të përpjestohet për pesë komuna është 25,600.00 euro

Shpenzime operacionale janë 2,150.00 € për secilën komunë (10,750.00€ total) ndërsa shumën e mbetur përpjestohet duke u bazuar në përqindjen e rasteve të strehuara për komunë.

Komunat	Numri i viktimave Janar-dhjetor 2024(149 raste)	Nr i viktimave %	Shpenzimet operacionale	Shpenzimet direkte	Total
Prishtinë	91	61.07%	2,150.00 €	9,066.00 €	11,216.00 €
Podujevë	12	8.05%	2,150.00 €	1,194.00 €	3,344.00 €
Fushë Kosovë	33	22.15%	2,150.00 €	3,294.00 €	5,444.00 €
Lipjani	7	4.70%	2,150.00 €	698.00 €	2,848.00 €
Obiliqi	6	6.5%	2,150.00 €	598.00 €	2,748.00 €

Me respekt,

Zana Hamiti-Asllani
Drejtoreshë e QMGF-së
Datë: 16.05.2025





Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo



Komuna
Fushë Kosovë



Komuna
Lipjan



Komuna
Obiliq



Komuna
Podujevë



Komuna
Prishtinë

MEMORANDUM MIRËKUPtimi

NË MES TË

KOMUNËS SË FUSHË KOSOVËS
KOMUNËS SË LIPJANIT
KOMUNËS SË OBILIQIT
KOMUNËS SË PODUJEVËS
KOMUNËS SË PRISHTINËS

DHE

QENDRËS PËR MBROJTJEN E GRAVE DHE FËMIJËVE (QMGF) - PRISHTINË

Në pajtim me nenin 17.1 (k) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28) dhe në pajtim me statutet e komunave respektive,

Komunat Fushë Kosovë, Lipjan, Obiliq, Podujevë dhe Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm “komunat”) në njëri-tjetër dhe

Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve Prishtinë, (në tekstin e mëtejshëm “strehimorja”), si palë pajtohen si më poshtë:

Memorandum i Mirëkuptimit (MM)

**Për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për strehimoren për një periudhë tre (3) vjeçare:
2023, 2024, 2025**

Neni 1

Qëllimi i Memorandumit të Mirëkuptimit

1. Komunat zotohen të ofrojnë mbështetje financiare për strehimoren që ajo të kryejë funksionin e saj në mbrojtje të viktimave të dhunës familjare dhe atyre të dhunës gjinore.
2. Objekti i strehimores gjendet në komunën e Prishtinës dhe ju shërben të pesë (5) komunave të sipërpërmendura.

Neni 2

Obligimet e Komunave

1. Komunat do të kontribuojnë bashkarisht për nevojat financiare të strehimores duke u bazuar në Planin Vjetor Financiar dhe Operacional të strehimores.
2. Kontributi financiar i secilës komunë përbëhet nga dy komponenta:
 - 2.1 Shuma e barabartë vjetore për secilën komunë për mbulimin e shpenzimeve operacionale dhe të mirëmbajtjes.
 - 2.2 Shuma e ndryshueshme vjetore, sipas nivelit dhe kostos së shërbimeve të ofruara për viktimat - banorë të komunave respektive, gjatë vitit të kaluar kalendarik.
3. Për vitin 2023, kontributi financiar për komunat është si më poshtë:
Komuna e Fushë Kosovës – EUR 4,200
Komuna e Lipjanit – EUR 3,300
Komuna e Obiliqit – EUR 3,300
Komuna e Podujevës – EUR 3,300
Komuna e Prishtinës – EUR 11,500
4. Për vitet 2024 dhe 2025, kontributet do të përllogariten sipas nenit 2, paragrafi 2 dhe metodologjisë së përcaktuar në Shtojcën 1.

5. Një grup i përbashkët pune me përfaqësues nga të gjitha komunat e përfshira do të përcaktojë kontributet për 2024 dhe 2025, jo më vonë se 20 janari i vitit respektiv. Këto vendime do të paraqiten në Shtojcën 1.

6. Nëse disa komuna vendosin ta rrisin kontributin e tyre me vetëdëshirë, kjo nuk do të ketë pasoja për obligimet e komunave tjera të përcaktuara në MM.

7. Fondet për kontributet do të alokohen nga kategoritë buxhetore Subvencione dhe Transfere dhe do të transferohen në llogarinë e strehimores në një pagesë të vetme, jo më vonë se data 31 janar e secilit vit fiskal.

Neni 3

Obligimet e strehimores

1. Strehimorja do të dorëzojë një kërkesë zyrtare për ndihmë financiare bashkë me Planin Vjetor Financiar dhe Operacional të komunat, jo më vonë se data 15 janar në vitin për të cilin ndihma kërkohet.
2. Strehimorja është e obliguar të dorëzojë një raport financiar tre (3) muajor bashkë me faturat përkatëse të komunat.
3. Strehimorja është e obliguar të dorëzojë një raport financiar vjetor jo më vonë se data 31 dhjetor. Raporti duhet të përmbajë një pasqyrë statistikore që tregon se sa viktima ka shërbyer strehimorja gjatë vitit dhe nga cilat komuna vijnë ato.
4. Në rast të mosrespektimit të ndonjërit nga paragrafet e nenit 3, komunat kanë të drejtë të mos kryejnë pagesat respektive deri sa të zbatohen obligimet.

Neni 4

Dispozitat përfundimtare

1. Kryetarët e komunave do të sigurojnë implementimin e plotë të këtij MM.
2. MM do të nënshkruhet në gjashtë (6) kopje origjinale dhe secila palë do të ketë një kopje.
3. MM hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
4. MM do të publikohet në uebfaqet e komunave.

Neni 5

1. Mosmarrëveshjet mes palëve do të zgjidhen me vullnetin e mirë të palëve.

Prishtinë, data: 04 tetor 2022

5. Një grup i përbashkët pune me përfaqësues nga të gjitha komunat e përfshira do të përcaktojë kontributet për 2024 dhe 2025, jo më vonë se 20 janari i vitit respektiv. Këto vendime do të paraqiten në Shtojcën 1.

6. Nëse disa komuna vendosin ta rrisin kontributin e tyre me vetëdëshirë, kjo nuk do të ketë pasoja për obligimet e komunave tjera të përcaktuara në MM.

7. Fondet për kontributet do të alokohen nga kategoritë buxhetore Subvencione dhe Transfere dhe do të transferohen në llogarinë e strehimores në një pagesë të vetme, jo më vonë se data 31 janar e secilit vit fiskal.

Neni 3

Obligimet e strehimores

1. Strehimorja do të dorëzojë një kërkesë zyrtare për ndihmë financiare bashkë me Planin Vjetor Financiar dhe Operacional të komunat, jo më vonë se data 15 janar në vitin për të cilin ndihma kërkohet.
2. Strehimorja është e obliguar të dorëzojë një raport financiar tre (3) muajor bashkë me faturat përkatëse të komunat.
3. Strehimorja është e obliguar të dorëzojë një raport financiar vjetor jo më vonë se data 31 dhjetor. Raporti duhet të përmbajë një pasqyrë statistikore që tregon se sa viktima ka shërbyer strehimorja gjatë vitit dhe nga cilat komuna vijnë ato.
4. Në rast të mosrespektimit të ndonjërit nga paragrafet e nenit 3, komunat kanë të drejtë të mos kryejnë pagesat respektive deri sa të zbatohen obligimet.

Neni 4

Dispozitat përfundimtare

1. Kryetarët e komunave do të sigurojnë implementimin e plotë të këtij MM.
2. MM do të nënshkruhet në gjashtë (6) kopje origjinale dhe secila palë do të ketë një kopje.
3. MM hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
4. MM do të publikohet në uebfaqet e komunave.

Neni 5

1. Mosmarrëveshjet mes palëve do të zgjidhen me vullnetin e mirë të palëve.

Prishtinë, data: 04 tetor 2022

Nënshtkruesit e Memorandumit të Mirëkuptimit

PËR KOMUNAT:


777.

Kryetari

Komuna e Fushë Kosovës


Kryetari

Komuna e Lipjanit




Kryetari

Komuna e Obiliqit



Kryetari


Komuna e Podujevës

pet: 

Kryetari

Komuna e Prishtinës

PËR STREHIMOREN:



Drejtoreshë e QMGF

Metodologjia për përcaktimin e kontributeve për komunat, për vitet 2024 dhe 2025

1. Shpenzimet vjetore të strehimores (sipas Planit Vjetor Financiar dhe Operacional)
2. Kontributet e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.
3. Shuma totale e kontributeve vjetore të komunave sipas MM: #1 - #2.
4. Përcaktimi/përlllogaritja e kostos së mirëmbajtjes së strehimores (sipas Planit Vjetor Financiar dhe Operacional)
5. Përlllogaritja e kontributeve komunale financiare individuale (Komponenta 1): #4 / 6
6. Përcaktimi/përlllogaritja e kostos së shërbimeve të ofruara nga ana e strehimores (sipas Planit Vjetor Financiar dhe Operacional)
7. Përcaktimi/përlllogaritja e ndarjes (në %) së viktimave nga secila komunë, në raport me numrin total të viktimave (sipas Raportit Vjetor Financiar).
8. Përlllogaritja e kontributeve komunale financiare individuale (Komponenta 2): #6 * #7.
9. Kontributi final vjetor për komunë: #5 + #8. (Komponenta 1 + 2)